

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE GUSHT 2022

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
1	30.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me tërheqjen e bonusit të fëmijës	02.08.2022	<p>Përshëndetje e nderuar, Në vijim të kërkesës Tuaj, Ju bëjmë me dije se tërheqja e çekut (bonusi) bëhet personalisht nga prindi/prindërit dhe afati është 1 vit kalendarik nga dita e lindjes së foshnjës. Në rast se ju nuk mund të jeni të pranishëm, me një Prokurë të Posaçme mund të autorizoni një të afërm të bëjë regjistrimin e fëmijës, si edhe të kryejë edhe tërheqjen e çekut të bebes.Për të kryer regjistrimin e fëmijës në regjistrin kombëtar të popullsisë në Shqipëri, duhet të dërgoni pranë familjarëve tuaj këto dokumenta:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Prokurë e Posaçme për personin që do të kryejë regjistrimin dhe kopje të letërnjoftimeve elektronike të dy prindërve; • Aktin e lindjes të mbajtur jashtë shtetit, i cili duhet të jetë legalizuar me vulë Apostile dhe i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar. <p>Në vijim, prindi pajiset me Regjistrimin e aktit të lindjes, Certifikatën e aktit të lindjes, Certifikatën familjare dhe Certifikatën personale të të porsalindurit.Në përfundim të regjistrimit të të porsalindurit, me qëllim përfundimit të bonusit, nëpunësi i gjendjes civile ju pajis me 2 (Dy)</p>	E plotë	Nuk ka

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

² Data e regjistrimit të kërkesës

³ Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴ Data e kthimit të përgjigjes

⁵ Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶ Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

⁷ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

				certifikata, përkatësisht: Certifikatë famjiljare dhe Certifikatë lindje e të porsalindurt, më shënimin “Për bonusin e lindjes”.Personi i autorizuar (i pajisur me prokurë të posacme) duhet të paraqitet pranë Shërbimit Social Shtetëror në Sektorin e financës, me qëllim dorëzimin e 2 (dy) certifikatave (familjare dhe lindje e fëmijës) dhe përfitim të çekut të bonusit të lindjes, sipas masës së përcaktuar. Për çdo pyetje ose paqartësi n’a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalin e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!		
2	01.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me problemet e shfaqura gjatë procesit të aplikimit të shërbimit QKB-së	02.08.2022	Përhëndetje,Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Si rrjedhojë, gjeni bashkëngjitur kërkesën e zyrës legale për problemet e shfaqura gjatë procesit të aplikimit.Faleminderit!	E deleguar	Nuk ka
3	01.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me problemet e shfaqura gjatë procesit të aplikimit të shërbimit ASJK-së	02.08.2022	Përhëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Si rrjedhojë, gjeni mëposhtë kërkesën e qytetarit për asistencë për një problem në llogarinë e tij në portalin e-albania. Lutemi për një përgjigje drejtuar shqetësimit të qytetarit. Faleminderit!	E deleguar	Nuk ka
4	02.08.2022	Kërkesë për informacion në	02.08.2022	Përhëndetje,Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se:	E deleguar	Nuk ka

		lidhje me problemet e shfaqura gjatë procesit të aplikimit të shërbimit të QKB-së		“Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Si rrjedhojë, gjeni bashkëngjitur ankesën e qytetarit për mungesën e arsyeve të refuzimit të aplikimit për licencë.Faleminderit!		
5	01.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me refuzimin e licencës së farmacisë	02.08.2022	Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse aplikimi i mëparshëm është refuzuar, duhet të riaplikoni. https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=4607 . Nëse aplikimi nuk shkon deri në fund, ose për problematika gjatë aplikimit, dërgoni email në adresën: asistencaonline@qkb.gov.al . Ose kontaktoni kujdesin e klientit të Qendrës Kombëtare të Biznesit ne numrin 042250066.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit	E plotë	Nuk ka
6	01.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me rifreskimin e certifikatës së pasurisë	02.08.2022	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se certifikata e pronësisë nuk rifreskohet. Lëshohet vetëm një herë. E rifreskuar merret kartela e pasurisë. Për këtë, duhet të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin: “Aplikim për lëshim kopje karteletë së pasurisë”, në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9461 . Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit	E plotë	Nuk ka
7	01.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me pajisjen me certifikatë të pasurisë	02.08.2022	Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion Ju bëjmë me dije se portali e-albania për shërbimet e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës është në funksion të plotë. Lutemi kontrolloni seksionin "Dokumentat e mia" në llogarinë Tuaj	E plotë	Nuk ka

				në e-albania. Aty do të gjeni përgjigjet dhe dokumentat për të cilat keni aplikuar. Është mënyra e vetme e marrjes së dokumenteve me vulë elektronike.Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!		
8	01.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me kriteret për pranimin në universitet për vitin akademik 2022-2023	02.08.2022	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion Ju bëjmë me dije se kriteret e pranimit në universitet dhe kuotat për vitin akademik 2022 – 2023 i gjeni në linkun e mëposhtëm: [https://unitir.edu.al%20%0D/] https://unitir.edu.al Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
9	02.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me pajisjen me leje drejtimi pasi ka kryer konvertimin në Itali dhe tashmë i ka skaduar	02.08.2022	Përshëndetje znj.....Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brënda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Si rrjedhojë, po ju parashtrijmë kërkesën e ardhur në emailin tonë zyrtar ku qytetari interesohet për procedurën e pajisjes me leje drejtimi pasi ka kryer konvertimin në Itali dhe tashmë i ka skaduar.Lutemi, një përgjigje drejtuar qytetarit. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit	E deleguar	Nuk ka
10	01.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me problemet e shfaqura gjatë procesit të aplikimit të	02.08.2022	Përshëndetje z....Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brënda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk	E deleguar	Nuk ka

		shërbimit të ASJK-së		e zotëron informacionin e kërkuar”. Si rrjedhojë, po ju parashtrijmë kërkesën e ardhur në adresën zyrtare të emailit ku qytetari ankohet për mos lëvrimin e shërbimit nga ASHK-ja. Lutemi një sqarim për problematikën e paraqitur.Për çdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit		
11	30.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me procedurën dhe dokumentat e lidhjes së martesës	02.08.2022	<p>Përsëritet, Në vijim të kërkesës Tuaj, do të gjeni më poshtë një informacion të përmbledhur mbi procedurën e shpalljes së martesës:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. 2. Shpallja e martesës bëhet nga të Dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. 3. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesa. <p>Dokumentet e nevojshëm për shpalljen e martesës janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. prokurë e posaçme, në rastet kur bashkëshortët e ardhshëm nuk janë prezent në procedurën e shpalljes; 2. certifikatë lindje, me shënimin “për shpallje martesë”; 3. fotokopje e dokumentit të identifikimit; <p>Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Nëse martesa do të lidhet në një shtet të huaj, pas kalimit të afatit 10 ditor nga shpallja e martesës, duhet të pajisen me këto dokumente:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. certifikatë lindje; 2. certifikatë lindje, me shënim “për lidhje martesë”; 	E plotë	Nuk ka

				Këto dokumente duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për të ndjekur më pas procedurën e lidhjes së martesës sipas legjislacionit të vendit të huaj ku bashkëshortët e ardhshëm kanë vendqëndrimin. Aplikimet për legalizim kryhet në zyrat e Postës Shqiptare. Për çdo pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalin e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
12	30.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me vonesën në lëvrimin e shërbimit Njësimit notash	02.08.2022	Përsëritje z.Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" neni 10, pika "d" përcakton se: "Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar". Si rrjedhojë, gjeni bashkëngjitur kërkesën e mëposhtme, ku qytetari kërkon të informohet për kërkesën e tij për shërbimin, Njësimit notash, për të cilin nuk ka marrë akoma përgjigje. Lutemi për një përgjigje drejtuar shqetësimit të znj....Faleminderit!	E deleguar	Nuk ka
13	02.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me problemet e shfaqura gjatë procesit të aplikimit të shërbimit dorëzim pasqyrash finaciare	02.08.2022	Përsëritje,Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" neni 10, pika "d" përcakton se: "Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar". Si rrjedhojë, gjeni bashkëngjitur kërkesën e qytetarit për asistencë mbi përfundimin e aplikimit.Faleminderit!	E deleguar	Nuk ka
14	02.08.2022	Kërkesë për	02.08.2022	Përsëritje e nderuar,Në vijim të kërkesës Tuaj, Ju bëjmë	E plotë	Nuk ka

		informacion në lidhje me afatet dhe procedurat e përfitimit të bonusit		<p>me dije se tërheqja e çekut (bonusi) bëhet personalisht nga prindi/prindërit dhe afati është 1 vit kalendarik nga dita e lindjes së foshnjës. Në rast se ju nuk mund të jeni të pranishëm, me një Prokurë të Posaçme mund të autorizoni një të afërm të bëjë regjistrimin e fëmijës, si edhe të kryejë edhe tërheqjen e çekut të bebes. Për të kryer regjistrimin e fëmijës në regjistrin kombëtar të popullsisë në Shqipëri, duhet të dërgoni pranë familjarëve tuaj këto dokumenta:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Prokurë e Posaçme për personin që do të kryejë regjistrimin dhe kopje të letërnjoftimeve elektronike të dy prindërve; • Aktin e lindjes të mbajtur jashtë shtetit, i cili duhet të jetë legalizuar me vulë Apostile dhe i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar. <p>Në vijim, prindi pajiset me Regjistrimin e aktit të lindjes, Certifikatën e aktit të lindjes, Certifikatën familjare dhe Certifikatën personale të të porsalindurit. Në përfundim të regjistrimit të të porsalindurit, me qëllim përftimin e bonusit, nëpunësi i gjendjes civile ju pajis me 2 (Dy) certifikata, përkatësisht: Certifikatë familjare dhe Certifikatë lindje e të porsalindurit, më shënimin "Për bonusin e lindjes". Personi i autorizuar (i pajisur me prokurë të posaçme) duhet të paraqitet pranë Shërbimit Social Shtetëror në Sektorin e financës, me qëllim dorëzimin e 2 (dy) certifikatave (familjare dhe lindje e fëmijës) dhe përftimin e çekut të bonusit të lindjes, sipas masës së përcaktuar. Për çdo pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalën e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!</p>		
15	02.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me	02.08.2022	Përhëndetje i nderuar, Në vijim të pyetjes suaj, ju bëjmë me dije se përsa i përket shërbimit " Aplikim për pasaportë	E plotë	Nuk ka

		aplikimin rinovim pasaporte për fëmijën		<p>biometrike"ju mund të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania. Referuar vendimeve të fundit të Policisë së Shtetit Ju informojmë se: Për të kryer aplikimin për pajisje të Pasaportës Biometrike për herë të parë sic është rasti juaj, ju nevojitet të plotësoni online në portalin e-Albania formularin e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, duke klikuar: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9765Pas shqyrtimit të aplikimit, ju do të njoftoheni brenda 1 dite për aplikim me procedurë të përshpejtuar dhe brenda 7 ditësh për aplikim normal nga Policia e Shtetit, dhe më pas duhet të vijoni me rezervimin e takimit prane zyrave të ALEAT.Për të rezervuar takimin ju duhet të bëni rezervimin në adresën: https://rezervo.aleat.al/</p> <p>Klikoni linkun dhe plotësoni të dhënat e kërkuara tek plotësimi i nr ID për fëmijën ju rikujtojmë që mund ta gjeni tek certifikata e lindjes</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Zgjidh datën dhe orarin 2. Në fund zgjidh rezervo <p>Mos harroni të çekoni opsionin Kushtet e përdorimit. Për rinovimin e pasaportës duhet të paraqiteni në zyrën ALEAT ku keni vendbanimin. Për çdo pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalën e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 16:00. Faleminderit!</p>		
16	02.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me aplikimin rinovim pasaporte	03.08.2022	<p>Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se si rezultat i sulmit kibernetik ndaj e-albanias, lutemi drejtohuni në sportelet e komisariatit të policisë për të aplikuar për formularin për rinovim ose pajisje për herë të parë me pasaportë. Dokumentat që duhet të keni me vete janë:</p>	E plotë	Nuk ka

				<ul style="list-style-type: none"> • Karta e identitetit • Dy foto format dokument 4x5 <p>Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit</p>		
17	03.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me aplikimin rinovim pasaporte	03.08.2022	<p>Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se shtetasit mund të aplikojnë për Pasaportë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Me procedurë normale - (Afati kohor i prodhimit të pasaportës është 15 ditë kalendarike) • Me procedurë të Përshpejtuar - (Afati kohor i prodhimit të pasaportës është 2-3 ditë kalendarike) <p>Për fëmijet nën moshën 16 vjeç duhet të jetë prezent njëri nga prindërit, një person i Autorizuar me Prokurë ose kujdestari ligjor! Ju jeni mbi 16 vjeç kështu që mund të aplikoni pa praninë e prindit. Dokumentat e nevojshme janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kuponi original (<i>Normale / të Përshpejtuar</i>) i blerë në Postë. • Formulari i Vetëdeklarimit i Policisë për aplikim Pasaporte*. • Kartë ID e vlefshme (për shtetasit mbi moshën 16 vjeç). <p>Ju duhet të bëni rezervimin në adresën: https://rezervo.aleat.al/. Klikoni linkun dhe plotësoni të dhënat e kërkuara.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Zgjidh datën dhe orarin 2. Në fund zgjidh rezervo <p>Mos harroni të çekoni opsionin Kushtet e përdorim. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit</p>	E plotë	Nuk ka
18	04.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me	04.08.2022	<p>Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se para se ju mund të aplikoni për kartë ID pa</p>	E plotë	Nuk ka

		aplikimin rinovim ID kartë		ju përfunduar afati.Duhet vetëm të rezervoni në këtë link https://rezervo.aleat.al/ për datën dhe orën e paraqitjes në sportelin ALEAT. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
19	05.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me procedurën dhe mënyrën e aplikimit për rimbursim shpenzime vdekje jashtë vendit.	05.08.2022	Përshëndetje znj.....Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Si rrjedhojë, po ju parashtrajmë kërkesën e ardhur në email-in tonë zyrtar ku qytetari interesohet për procedurën dhe mënyrën e aplikimit për rimbursim shpenzime vdekje jashtë vendit.Lutemi, një përgjigje drejtuar qytetarit. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit	E deleguar	Nuk ka
20	06.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me procedurën e pajisjes me rinovim dëshmie së aftësisë së lundrimit.	08.08.2022	Përshëndetje,Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim të një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Bashkëngjitur gjeni kërkesën e ardhur në emailin tonë zyrtar nga z....., i cili kërkon të informohet mbi procedurat që duhet të ndjekë për të marrë pajisje me rinovim dëshmie së aftësisë së lundrimit.. S’a më sipër, lutemi për një përgjigje nga ana juaj. Faleminderit!	E deleguar	Nuk ka
21	07.08.2022	Kërkesë e paqartë për shërbimin që	08.08.2022	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se kërkesa Juaj është e pa plotë. Në kërkesën	E plotë	Nuk ka

		interesohet qytetari për të kryer aplikimin		Tuaj nuk referoni emrin e shërbimit që nuk arrini të aplikoni. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit		
22	06.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me pajisje me vërtetim mbi derdhjen e kontributeve	08.08.2022	<p>Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të marrë informacion mbi kontributet, në e-albania mund të aplikoni këto shërbime:</p> <p>Vërtetim për periudha pune në ndërmarrje shtetërore (para datës 01.01.1994) https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13886</p> <p>Vërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore nga 01.01.1994 deri 31.12.2011 https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13888</p> <p>Vërtetim për periudha pune në ish - kooperativat bujqësore (KB) https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13885</p> <p>Vërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore (pas datës 01.01.2012) https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13908</p> <p>Zgjidhni periudhën për të cilën interesoheni dhe bëni aplikimin. Pas shqyrtimit nga ISSH, vërtetimet i gjeni në seksionin “Dokumentat e mia” në llogarinë Tuaj në e-albania. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit</p>	E plotë	Nuk ka
23	06.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me kryerjen e aplikimit	08.08.2022	<p>Përshëndetje! Në vijim të pyetjes suaj, ju bëjmë me dije se procedura e njësimimit të diplomave të lëshuara nga Institucionet e Arsimit të Lartë është e spjeguar në linkun më poshtë:</p>	E plotë	Nuk ka

		<p>njëhësim diplome si dhe mbi kriteret për pranim në universitet për vitin akademik 2022-2023</p>		<p>https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=853</p> <p>Portali e-albania mundëson që shtetasit e huaj të logojnë direkt në portal. Pasi të klikoni butonin "Përdor", lutemi të klikoni te rrethi Passport/ID dhe të vendosni të dhënat e shtetasit të huaj. Më pas vazhdoni me plotësimin e formularit dhe ngarkimin e dokumentave. Pasi të keni përfunduar me ngarkimin e dokumentave dhe pagesës on line, lutemi që dokumentacionin e noterizuar ta dërgoni me postë në QSHA. Nëse nuk arrini të përdorni portalin e-albania, mund të paraqiteni në QSHA me dokumentat e skanuara në USB dhe punonjësit e QSHA do ju ndihmojnë të bëni aplikimin on line. Në linkun e mëposhtë mund të gjeni info mbi kriteret e pranimin për cdo universitet:</p> <p>https://maturashteterore.com/kriteret-e-universiteteve-2022-2023/. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit</p>		
24	05.08.2022	<p>Kërkesë për informacion në lidhje me procedurën e njësimit të diplomës në momentin që nuk arrin ta kryej aplikimin online.</p>	08.08.2022	<p>Përshëndetje z.... Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" neni 10, pika "d" përcakton se: "Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brënda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar". Si rrjedhojë, po ju parashtrijmë kërkesën e ardhur në emailin tonë zyrtar të znj..., e cila interesohet për procedurën e njësimit të diplomës në momentin që nuk arrin ta kryej aplikimin online. Lutemi, një përgjigje drejtuar znj.... Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit</p>	E deleguar	Nuk ka

25	08.08.2022	Kërkesë e paqartë për pajisjen me leje kalimi	09.08.2022	Përshëndetje, Në vijim të emailit tuaj, Ju lutem n'a dërgoni një kërkesë më të plotë që të kemi mundësinë tju informojmë. Në cilin shtet jetoni në mënyrë që t'i drejtohem përfaqësisë sonë diplomatike në atë shtet. Për cdo pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalën e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
26	08.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me pajisjen me certifikatë pronësie kur prona është fituar nga babai me ligjin 7501	09.08.2022	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të marrë informacion për çështjen që referoni në kërkesën për informacion, aplikoni nga llogaria e babait në e-albania shërbimin: “Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë)”, në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9477 . Procedura duhet të shoqërohet me një kërkesë me shkrim nga ana Juaj në format PDF, në të cilën do ta ngarkoni në hapin e tretë të aplikimit. Agjencia Shtetërore e Kadastrës do t'ju pajisë me informacionin që kërkonti. Nëse Ju keni qenë pjesë e certifikatës familjare të vitit 1991, kohë kur është bërë marrja e tokës në përdorim, mund ta kërkonti këtë informacion edhe nga llogaria Juaj personale në e-albania. Gjithsesi, mënyra e drejtë është që këtë kërkesë për informacion ta iniciojë babai Juaj nga llogaria e tij, pasi AMTP-të janë lëshuar në emër të kryefamiljarit. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
27	08.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me pajisjen me certifikatë pronësie	09.08.2022	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të marrë informacion për çështjen që referoni në kërkesën për informacion, aplikoni nga llogaria e babait në e-albania shërbimin: “Aplikim për informacion	E plotë	Nuk ka

				zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë)”, në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9477 . Procedura duhet të shoqërohet me një kërkesë me shkrim nga ana Juaj në format PDF, në të cilën do ta ngarkoni në hapin e tretë të aplikimit. Agjencia Shtetërore e Kadastrës do t’Ju pajisë me informacionin që kërkon. Për çdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
28	09.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me aplikimin e kryer pranë QKB-së për ndryshim të dhënash	09.08.2022	Përsëritje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Si rrjedhojë, gjeni bashkëngjitur kërkesën e qytetarit për asistencë mbi aplikimin e kryer. Faleminderit!	E deleguar	Nuk ka
29	09.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me kërkesën e kryer për përfitimin e statusit i verbër	09.08.2022	Përsëritje znj....Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Si rrjedhojë, lutem gjeni mëposhtë kërkesën e ardhur në adresën tonë zyrtare nga z....., i cili interesohet për kërkesën e kryer për përfitimin e statusit i verbër. Gjithashtu bashkëlidhur dhe emaili drejtuar në adresën tone zyrtare. Lutemi për një përgjigje drejtuar shqetësimit të z.....Faleminderit!	E deleguar	Nuk ka

30	09.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me procedurën e njësimit të diplomës në momentin që nuk arrin ta kryej aplikimin online.	09.08.2022	Përshëndetje Zj....Shpresoj që ky e-mail tju gjejë mirë.QSHA është në komunkim të vazhdueshëm me AKSHI përta i përket rivendosjes në funksion të shërbimit të njësimit të diplomave, por ende nuk kemi një përgjigje se kur ky shërbim do të rivendoset në funksion. Ju lutem dërgoni me postë në adresë të QSHA dokumentacionin shkresor në mënyrë që të fitojmë kohë.Kur të rivendoset në funksion shërbimi, mund të bëni dhe aplikimin on line.Gjithë të mirat.	E plotë	Nuk ka
31	09.08.2022	Kërkesë e ardhur nga studio ligjore për pajisje me leje qëndrimi provizore për dy shtetas të huaj.	10.08.2022	Përshëndetje z.....Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Si rrjedhojë, gjeni bashkëngjitur kërkesën e mëposhtme, ku studio ligjore paraqet kërkesën e saj për pajisje me leje qëndrimi provizore për dy shtetas të huaj.Lutemi për një përgjigje drejtuar shqetësimit të zyrës Legal & Tax Albania.Faleminderit!	E deleguar	Nuk ka
32	10.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me procedurën për lidhje martesë jashtë vendit	10.08.2022	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj, do të gjeni më poshtë një informacion të përmbledhur mbi procedurën e shpalljes së martesës: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. 2. Shpallja e martesës bëhet nga të Dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. 3. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesa. Dokumentet e nevojshëm për shpalljen e martesës janë: <ol style="list-style-type: none"> 1. prokurë e posaçme, në rastet kur bashkëshortët e 	E plotë	Nuk ka

				<p>ardhshëm nuk janë prezent në procedurën e shpalljes;</p> <ol style="list-style-type: none"> 2. certifikatë lindje, me shënimin “për shpallje martesë”; 3. fotokopje e dokumentit të identifikimit; <p>Ju mund të aplikoni për tu pajisur me kartë identiteti në mënyrë që të vazhdoni procedurën për tu pajisur me leje martesë. Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Nëse martesë do të lidhet në një shtet të huaj, pas kalimit të afatit 10 ditor nga shpallja e martesës, duhet të pajisen me këto dokumente:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. certifikatë lindje; 2. certifikatë lindje, me shënim “për lidhje martesë”; <p>Këto dokumente duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për të ndjekur më pas procedurën e lidhjes së martesës sipas legjislacionit të vendit të huaj ku bashkëshortët e ardhshëm kanë vendqëndrimin. Aplikimet për legalizim kryhet në zyrat e Postës Shqiptare. Për çdo pyetje ose paqartësi n’a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalën e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!</p>		
33	10.08.2022	Kërkesë për informacion nëse duhet të aplikojnë për pajisje me leje drejtimi automjeti me	10.08.2022	Përshëndetje znj.....Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Si	E deleguar	Nuk ka

		specifikimet teknike bashkelidhur.		rrjedhojë, po ju parashtrojmë kërkesën e ardhur në emailin tonë zyrtar ku studio ligjore interesohet nëse duhet të aplikojnë për pajisjes me leje drejtimi për mjetin me karakteristikat e mëposhtme si dhe specifikimet teknike bashkelidhur.Lutemi, një përgjigje drejtuar studios ligjore.Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit		
34	11.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me procedurën që duhet të ndjek për rideklarimin e pasqyrave financiare pas ndryshimeve të kryera.	11.08.2022	Përshëndetje zj.....Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Si rrjedhojë, gjeni bashkëngjitur kërkesën e z....., i cili kërkon të informohet mbi procedurën që duhet të ndjek për rideklarimin e pasqyrave financiare pas ndryshimeve të kryera.Lutemi, një përgjigje drejtuar z....Faleminderit!	E deleguar	Nuk ka
35	11.08.2022	Kërkesë për reset passwordi në llogarinë e-albania	11.08.2022	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të gjeneruar një password të ri duhet të veproni si më poshtë: Nëse nuk keni akses tek emaili me të cilin jeni rregjistruar në portal, hapni një adresë të re email dhe dërgoni këto të dhëna në adresën helpdesk@e-albania.al: - foto të kartës ID - emri i nënës - emri i babait - datëlindja e nënës Specifikoni gjithashtu adresën e re email që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në	E plotë	Nuk ka

				19:00. Faleminderit!		
36	11.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me aplikimin e kryer për pajisjen me certifikatë pasurie	11.08.2022	Përshëndetje znj. ...Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brënda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Si rrjedhojë, po ju parashtrojmë kërkesën e ardhur në adresën tonë zyrtare ku zj....., interesohet për aplikimin e kryer më datë 18.08.2022 dhe nr prot 17134.Lutemi, një përgjigje drejtuar zj.....Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit	E deleguar	Nuk ka
37	12.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me procedurën si kryhet aplikimi kur të mungojnë të dhënat e pronës	12.08.2022	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju lutem referojuni shënimit në krye të dokumentit bashkëlidhur ku citohet që në rastin kur nuk ka të dhëna për vol dhe faqe vendosni 999. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
38	11.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me procedurën e aplikimit kur nuk janë të sakta të dhënat e pronës	12.08.2022	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se për te marre informacion mbi ecurine e kerkeses per legalizim, duhet te aplikoni sherbimin: “Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë)” përmes platformës qeveritare e-Albania, në linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9477 . Fillimisht duhet të hartoni një kërkesë me shkrim, ku të sqaroni arsyet e përdorimit të këtij dokumenti. Kjo kërkesë duhet të firmoset nga ana juaj dhe të skanohet. Ajo do të ngarkohet në hapin e tretë të formularit në e-Albania.	E plotë	Nuk ka

				<p>Për të përdorur shërbimin, klikoni “Përdor” në fund të faqes dhe vijoni me plotësimin e formularit elektronik. Pavarësisht se Ju nuk keni të dhëna prone, për të orientuar sistemin duhet të vendosni një zonë të saktë kadastrale, ndersa volumin dhe faqen i vendosni 99. Zona kadastrale duhet jetë zona që përfshin parcelën tuaj ndërtimore.</p> <p>Për shembull:Nëse informacionin zyrtar e kërkonti për qytetin e Tiranës, do përzgjidhni Drejtoria vendore Tirana Veri dhe do të vendosni Zonë kadastrale 8110, volum 99, faqe 99. Klikoni butonin “Dërgo” në faqen e fundit të formularit. Numri i referencës së aplikimit do ju ndihmojë për të gjurmuar aplikimin dhe ngarkuar mandatpagesën. Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë për të kryer pagesën, ose kryeni pagesën online përmes portalit e-Albania me një kartë debiti ose krediti. Pas kryerjes së pagesës në bankë ose postë, duhet që t'i riktheheni edhe njëherë aplikimit për të ngarkuar mandatpagesën.</p> <p>Ngarkimi i mandatpagesës: Duhet të logoheni në e-Albania dhe të kërkonti shërbimin e aplikuar. Nuk do të kryeni aplikim të ri por do të shkoni në fund të formularit, në seksionin “Dërgo mandat-pagesën e një aplikimi të kryer”. Plotësoni të gjitha fushat, numrin e referencës së aplikimit e gjeni edhe tek “Mesazhet e mia”, ngarkoni faturën dhe më pas klikoni “Dërgo”.</p> <p>Në kërkesën Tuaj për informacion nuk referoni nëse aplikimin e keni shoqëruar me një kërkesë të detajuar me shkrim apo jo. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit</p>		
39	11.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me procedurën	12.08.2022	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se Agjencia Funerale është e detyruar T`ju pajisë me faturë tatimore për shpenzimet funerale. Pasi të	E plotë	Nuk ka

		kryerjes së mbylljes së pensionit pas vdekjes		<p>merrni faturën e shpenzimeve funerale duhet të aplikoni në e-albania shërbimin "Mbyllje pensioni", nëse i ndjeri ka qenë pensionist.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nëse është trajtuar me ndihmë ekonomike nga minibashkia, drejtohuni pranë minibashkisë për të përfituar shpenzimet e funeralit. • Nëse ka qenë ende në marrdhënie pune, faturën e shpenzimeve të funeralit dhe një certifikatë vdekje duhet t'i dorëzoni pranë qendrës së punës. <p>Për të bërë mbylljen e pensionit, duhet të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin” Aplikim për mbyllje pensioni” në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=6162</p> <p>Hapat e procedurës:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikohuni si qytetar në portalin e-Albania; • Zgjidhni shërbimin "Aplikim për mbyllje pensioni"; • Klikoni butonin "Përdor"; • Plotësoni formën përkatëse për këtë kërkesë dhe dërgoni aplikimin; • Dokumentet origjinale që i keni bashkëlidhur gjatë aplikimit duhet të dërgohen me postë pranë DRSSH përkatëse. <p>Ju lutem mbani në konsideratë që zarfi i përcjelljes së këtyre dokumenteve të shoqërohet me numrin e aplikimit tuaj. Pavarësisht se me cilin ligj e keni përfituar pensionin, për mbylljen e tij aplikohet vetëm në këtë link. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!</p>		
40	12.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me	12.08.2022	Përhëndetje,Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se:	E deleguar	Nuk ka

		aplikimin e kryer në QKB për ndryshim të dhënash dhe nuk ka marr nr cështje		“Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Si rrjedhojë, gjeni bashkëngjitur kërkesën e qytetarit për asistencë mbi aplikimin e kryer.Faleminderit!		
41	12.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me aplikimin e kryer në QKB	15.08.2022	Përshëndetje,Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Si rrjedhojë, gjeni bashkëngjitur kërkesën e qytetarit për asistencë mbi aplikimin e kryer.Faleminderit!	E deleguar	Nuk ka
42	14.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me kalimin e shtetases ruse në portin e Durrësit në drejtim të Italisë kur nuk është e pajisur me vizë Shengen	15.08.2022	Përshëndetje të nderuar,Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Si rrjedhojë, lutem gjeni mëposhtë kërkesën e ardhur në adresën tonë zyrtare nga zj....., e cila interesohet për: 1. A do të lejojë kontrolli i pasaportave në portin e Durrësit nisjen nga Shqipëria drejt Italisë nëse gruaja nuk kam vizë Shengen, por është e afërme e linjës së parë të një shtetasi të Ukrainës? Gjithashtu, për shkak të luftës nuk mund të kthehemi në Ukrainë, ku kanë jetuar me burrin për 7 vitet e fundit. 2. Nëse po. Nëse mund të mbështetemi në disa direktiva/dekrete/ligje kur do të kalojnë kufirin me	E deleguar	Nuk ka

				Shqipërinë? Lutemi për një përgjigje drejtuar shqetësimit të zj....Faleminderit!		
43	13.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me pajisjen me certifikatë nga akti i lindjes	15.08.2022	Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të marrë certifikatë nga akti i lindjes, për aktet e lindjes të regjistruara pas vitit 2010, duhet të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin “ Certifikatë nga akti i lindjes” në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=11176 . Ndërsa për aktet e regjistruara para vitit 2010, duhet të paraqiteni në zyrën e arkivave në Prefekturën e Qarkut ku është regjistruar akti i lindjes.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit	E plotë	Nuk ka
44	13.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me mënyrën e aksesimit të llogarisë në e-albania	15.08.2022	Përshëndetje,Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju informojmë se nëse nuk keni akses tek emaili me të cilin jeni rregjistruar në portal duhet të dërgoni këto të dhëna në adresën helpdesk@e-albania.al : <ul style="list-style-type: none"> • foto të kartës ID • emri i nënës • emri i babait • datëlindja e nënës Specifikoni gjithashtu adresën e re email që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit	E plotë	Nuk ka
45	13.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me aplikimin për shtetësi shqiptare	15.08.2022	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të bërë kërkesën për fitim shtetësie shqiptare duhet të aplikoni në portalin e-albania shërbimin “Kërkesë për fitim shtetësie” në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=	E plotë	Nuk ka

				<p>9627 .Dokumentacionin për secilin tip fitimi të shtetësisë e gjeni në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/DPPSH/9627/9627_dokumentacioni.pdf .Lidhur me faktin se Ju keni në përdorim shtëpinë e një shtetasi të Kosovës në Shqipëri, një nga dokumentet e kërkuara në procedurë është dhe Akti i pronësisë së banesës ose kontrata e zënies me qera të banesës (fotokopje e noterizuar). Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!</p>		
46	14.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me pajisjen licencë DDD	15.08.2022	<p>Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për T`u pajisur me Licence DDD, nga llogaria e biznesit në e-albania duhet të aplikoni shërbimin: Aplikim për licencë të re në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=4607. Në këtë link do të gjeni dhe licencën për të cilën jeni i interesuar. II.8.A - Shërbime ekspertize higjienoshëndetësore. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00, dhe Qendren Kombetare te biznesit ne kontaktet, 042250066, ose ne adresen email, info.qkb@qkb.gov.al. Faleminderit!</p>	E plotë	Nuk ka
47	14.08.2022	Kërkesë për informacion për punësim	15.08.2022	<p>Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të aplikuar për punësim, duhet të regjistroheshi në e-albania si punëkërkues i papunë. Aplikim për regjistrim si punëkërkues i papunë në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=</p>	E plotë	Nuk ka

				<p>12550. Zyra e Punësimit njofton aplikantin nëse aplikimi është pranuar apo refuzuar, së bashku me arsyetimin përkatës. Në rastin kur aplikimi është pranuar, atëherë Zyra e Punësimit i cakton një datë dhe orë aplikantit për takimin pranë kësaj zyre punësimi, në të cilën aplikanti duhet të paraqitet për intervistën për pune. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!</p>		
48	14.08.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me legalizimin e ndërtimit pa leje	15.08.2022	<p>Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të bërë kërkesë për legalizim, duhet të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin: “Kërkesë për legalizim të ndërtimit pa leje”, në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14542. Shërbimi elektronik "Kërkesë për legalizim të ndërtimit pa leje" u mundëson qytetarëve të aplikojnë online për legalizim dhe pajisje me dokument pronësie për ndërtimet pa leje, të ndërtuara pas datës 10.08.1991, për të cilat nuk është aplikuar më parë për legalizim. Dokumentet e nevojshem janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Certifikatë familjare; • Plan rilevimi nga topograf i licensuar; • Foto të objektit në të katër pozicionet. <p>Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!</p>	E plotë	Nuk ka
